1	Aktet ligjore dhe nënligjore	Rregullore për zhvillimin e olimpiadave dhe urdhri i datave të zhvillimit të tyre	Brenda muajit nëntor publikohet Rregullorja dhe Urdhri i zhvillimit të olimpiadave kombëtare, për nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, për vitin shkollor	MAS

2	Komisionet për hartimin dhe vlerësimin e testeve të olimpiadës	Urdhër i QSHA “Për ngritjen e komisioneve për hartimin dhe vlerësimin e testeve të olimpiadës”	Brenda muajit dhjetor Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA, “Për ngritjen e komisioneve për hartimin dhe vlerësimin e testeve të olimpiadës”. Në urdhër parashikohen rregullat dhe procedurat operative për hartimin dhe vlerësimin e testeve. Anëtarët e komisionit të hartimit dhe vlerësimit të testeve, fillimisht duhet të nënshkruajnë kontratën dhe deklaratën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetit.	Titullari DV SAP SPVKN
3	Shpallja e fituesve	Procesverbal për shpalljen e fituesve	Shpallja e fituesve bëhet jo më vonë se 7 ditë nga dita e zhvillimit të Olimpiadës. Përputhja e barkodeve me emrat e nxënësve bëhet në QSHA, në prani të përfaqësuesit të MASR.	DV SAP SPVKN
<b>LISTA E AKTIVITETEVE PËR OLIMPIADAT</b>				
1	Ngritja e komisioneve për hartimin dhe vlerësimin e testeve të olimpiadave	Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA, “Për ngritjen e komisioneve për hartimin dhe vlerësimin e testeve të olimpiadës”.	Brenda muajit dhjetor nxirret ky urdhër. Në urdhër parashikohen rregullat dhe procedurat operative për hartimin dhe vlerësimin e testeve. Anëtarët e komisionit të hartimit dhe vlerësimit të testeve, fillimisht duhet të nënshkruajnë kontratën dhe deklaratën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetit.	Titullari DV SAP SPVKN
2	Ngritja e Grupit të Punës për shumëfishimin, paketimin dhe shpërndarjen e testeve të olimpiadës”.	Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA, Ngritja e Grupit të Punës për shumëfishimin, paketimin dhe shpërndarjen e testeve të olimpiadës”.	Brenda muajit dhjetor nxirret ky urdhër. Në urdhër parashikohen rregullat operative për shumëfishimin, paketimin dhe shpërndarjen.	Titullari DV SAP SPVKN

3	Dërgimi i testeve të fazës së dytë	Shkresa të QSHA-së për dërgimin e testeve në ZVAP	Ky proces kryhet në muajt dhjetor-janar. Dy ditë para çdo provimi, komisionet për hartimin dhe vlerësimin e testeve të dorëzojnë me procesverbal testet e fazës së dytë Drejtorit të Përgjithshëm bashkë me çelësin e zgjidhjes (në USB). Procesverbali nënshkruhet nga ana e anëtarëve të Komisionit dhe marrësve në dorëzim dhe mbahet në dy kopje nga secila prej palëve. <b>Testet e fazës së dytë dërgohen në ZVA ZYRTARISHT me postë 1 ditë</b> para zhvillimit të olimpiadës.	Titullari DV SAP SPVKN
4	Publikimi i testit dhe çelësit të zgjidhjes në faqen e internetit të QSHA, për fazën e dytë	QSHA publikon testin dhe çelësin e zgjidhjes, për fazën e dytë	Një ditë pas zhvillimit të olimpiadës për secilën lëndë, QSHA publikon testin dhe çelësin e zgjidhjes, për fazën e dytë	DV SAP SPVKN
5	Ngritja e Komisionit për shqyrtimin e ankimeve të nxënësve të olimpiadave kombëtare, faza e dytë”.	Urdhër për ngritjen e Komisionit për shqyrtimin e ankimeve të nxënësve të olimpiadave kombëtare, faza e dytë”.	Në periudhën janar-shkurt ngrihet ky urdhër. Për fazën e dytë ankimet shqyrtohen nga QSHA. QSHA krijon një komision të posaçëm i cili shqyrton kërkesat e nxënësve <b>dhe i dërgon zyrtarisht brenda 5 ditëve në ZVA vendimet përkatëse.</b>	Titullari DV SAP SPVKN
6	Dorëzimi i testeve të fazës së tretë	Procesverbale për dorëzimin e testeve të fazës së tretë	Brenda muajit shkurt, komisionet për hartimin dhe vlerësimin e testeve të dorëzojnë me procesverbal testet e fazës së tretë (në USB) Drejtorit të Përgjithshëm bashkë me çelësin e zgjidhjes. Procesverbal nënshkruhet nga ana e anëtarëve të Komisionit dhe marrësve në dorëzim mbahet në dy kopje nga secila prej palëve. Hartimi dhe vlerësimi i testeve të Olimpiadës/ve për nxënësit e arsimit 9-vjecar dhe të mesëm, bëhet nga QSHA. Në fazën e tretë, testi i Olimpiadës, për secilën lëndë, për AML është i njëjtë për nxënësit e të gjitha klasave.	Titullari DV SAP SPVKN



7	Ngritja e Grupit të Punës për monitorimin e procesit të testimit, të fazës së tretë dhe caktimin e sekretuesve”.	Urdhër për ngritjen e Grupit të Punës për monitorimin e procesit të testimit, të fazës së tretë dhe caktimin e sekretuesve”.	Duke filluar nga data që zhvillohet provimi i matematikës faza e tretë, e në vijim QSHA monitoron zhvillimin e olimpiadave, faza e tretë. Punonjësit e QSHA e monitorojnë procesin dhe në përfundim marrin në dorëzim nga PA materialet e testimit dhe <b>i dorëzojnë ato në institucion, jo më vonë se tre orë nga orari i përfundimit të olimpiadës.</b> Në varësi të numrit të nxënësve që do të marrin pjesë në këtë fazë, QSHA cakton qendrat ku do të zhvillohet olimpiada. ZVA Tiranë cakton Përgjegjësit e Administrimit (PA) dhe Administratorët e Mjedisit (AM) të zhvillimit të olimpiadave kombëtare. ZVA Tiranë i dërgon zyrtarisht QSHA listën e PA-ve dhe AM-ve, <b>3 (tre) ditë përpara datës së zhvillimit të olimpiadës, për secilën lëndë.</b> PA kryen identifikimin e nxënësve pjesëmarrës në olimpiadë, sipas listës së ardhur nga QSHA <b>një orë përpara fillimit të saj.</b>	GP
8	Ngritja e Komisionit për shqyrtimin e ankimeve të nxënësve të olimpiadave kombëtare, faza e tretë”.	Urdhër i MAS “Për ngritjen e Komisionit për shqyrtimin e ankimeve të nxënësve të olimpiadave kombëtare, faza e tretë”.	Për të shqyrtuar ankesën/at e nxënësve të fazës së tretë, MAS ngre një komision të përbërë nga specialistë të QSHA, mësues të lëndëve përkatëse dhe pedagogë të propozuar nga IAL-të. Komisioni shqyrton ankesën/at dhe vendimin përfundimtar, të firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit e përcjell në MAS dhe në QSHA.	Komisioni
9	Publikimi i testit dhe çelësit të zgjidhjes në faqen e internetit të QSHA, për fazën e tretë	QSHA publikon testin dhe çelësin e zgjidhjes, për fazën e tretë	Një ditë pas zhvillimit të olimpiadës për secilën lëndë, QSHA publikon testin dhe çelësin e zgjidhjes, për fazën e tretë	DV SAP SPVKN
10	Shpallja e fituesve	Procesverbal për shpalljen e fituesve, për secilën lëndë. Dërgohet shkresa në MAS me emrat e nxënësve fitues.	Shpallja e fituesve bëhet jo më vonë se 7 ditë nga data e zhvillimit të olimpiadës. Përputhja e barkodeve me emrat e nxënësve bëhet në QSHA, në prani të përfaqësuesit të MAS. QSHA dërgon zyrtarisht në MAS procesverbalin me emrat e nxënësve fitues dhe renditjen e tyre sipas barkodeve.	DV SAP SPVKN

<b>11</b>	Publikimi i fituesve	Publikimi i fituesve në faqen e internetit	Emrat e fituesve të olimpiadave kombëtare, lënda e matematikës publikohen në faqen e website-it të QSHA	DV SAP SPVKN
<b>12</b>	Dërgim informacioni	Me shkresë zyrtare apo me e-mail	Dërgohet informacion MAS, institucioneve dhe individëve lidhur mbi olimpiadat	DV SAP SPVKN
<b>V</b>	<b>TESTET PËR AKADEMINË E SIGURISË</b>			
<b>1</b>	Aktet ligjore dhe nënligjore	Shkresë e Akademisë së Sigurisë	Sipas afatit të kërkuar nga Akademia e Sigurisë përgatitja e testeve	Akademia e Sigurisë
<b>2</b>	Hartimi i testeve	Urdhër i QSHA “Për ngritjen e komisioneve për hartimin e testeve	Sipas afatit të kërkuar	Titullari DV SAP SPVKN
<b>3</b>	Shumëfishimi, paketimi dhe shpërndarja	Urdhër për ngritjen e GP	GP është përgjegjës për shumëfishimin, paketimin dhe shpërndarjen e testeve për Akademinë e Sigurisë	eGP

VI	VLERËSIMI NDËRKOMBËTAR PISA			
1	Kampionimi i shkollave dhe nxënësve	Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE) dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS)	Në këtë fazë kryhen në portalet e PISA të gjitha detyrat që lidhen me kampionimin dhe përzgjedhjen e shkollave dhe nxënësve	MAS Titullari DV SPVKN SAP PA
2	Zhvillim i vlerësimit dhe kodimi i pyetjeve	Manualet, udhëzimet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga OECD	Në këtë fazë kryhet zhvillimi i vlerësimit dhe më pas vijohet me kodimin e pyetjeve	Titullari DV SPVKN SAP PA
3	Dorëzimi i databazës finale	Manualet, udhëzimet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga OECD	Në këtë fazë kryhet validimi dhe dorëzimi i databazës finale	Titullari DV SPVKN SAP PA
<b>LISTA E AKTIVITETEVE NË REND KRONOLOGJIK, VLERËSIMI NDËRKOMBËTAR PISA</b>				
1	Mbledhja e të dhënave të nxënësve për PISA	E-maile me OECD për realizimin e task-eve në portalet e PISA, si dhe komunikime me e-mail me ZVAP-et për mbledhjen e të dhënave të nxënësve	Ky aktivitet zhvillohet në periudhën nëntor-dhjetor	Titullari DV SPVKN SAP PA

2	Kontrollet për studimin kryesor (Main Survey Revisions sqi-ALB)	Task që do kryhet në portalet e PISA	Ky aktivitet zhvillohet në periudhën nëntor-dhjetor	Titullari DV SPVKN SAP PA
3	Kampionimi në KeyQuest i të dhënave të mbledhura nga ZVAP-et	Task që do kryhet në portalet e PISA	Ky aktivitet kryhet në portalin e PISA, në muajt shkurt dhe mars	Titullari DV SPVKN SAP PA
4	Rishikimet për pyetësorët në sistemin online (CB Questionnaires Main Survey Revisions sqi-ALB)	Task që do kryhet në portalet e PISA	Ky aktivitet kryhet në portalin e PISA, në muajin dhjetor	Titullari DV SPVKN SAP PA
5	Nominimi i PISA Quality Monitor	Dërgohet e-mail OECD me emrat e propozuar për PQM	Ky e-mail dërgohet në muajin janar	Titullari DV SPVKN SAP PA
6	Përcaktimi nga PISA i listës së shkollave që do të përfshihen në testim	Komunikim me e-mail me OECD	Sampling Task 8B – 8A -7AB. Përzgjedhja e shkollave nga PISA deri më 15 Janar. Do të përcaktohen shkollat e përzgjedhura	Titullari DV SPVKN SAP PA

7	Përcaktimi nga PISA i listës së nxënësve që do të përfshihen në testim	Komunikim me e-mail me OECD. Shkresa dhe e-maile me ZVAP-et	<p>Ky aktivitet do kryhet deri nga fundi i muajit shkurt. Masat për realizimin e këtij aktiviteti:</p> <p>Shkresë ZVAP lidhur me nxënësit që janë përzgjedhur në testim.</p> <p>Dërgimi i materialeve informuese DAR/ZA, për t'ju përcjellë shkollave materialet lidhur me testimin.</p> <p>Nxënësve të përzgjedhur tu jepen teste të PISA, të përgatitura nga QSHA-ja, për tu njohur me natyrën dhe llojin e pyetjeve të testimit.</p>	Titullari DV SPVKN SAP PA
8	Dërgimin e emrave të KR, AT nga shkollat	Komunikim me e-mail me ZVAP-et	Ky aktivitet do kryhet brenda gjysmës ë dytë të muajit mars. Kërkesë ZVAP- për dërgimin e emrave te KR, SA dhe TA për çdo shkollë të përzgjedhur, sipas formatit të përcaktuar, në mënyrë që të hartohet një plan për trajnimin direkt të tyre nga QSHA.	Titullari DV SPVKN SAP PA

9	Përgatitja e materialeve dhe trajnimi me KR/	Zhvillimi i trajnimit nga QSHA	Ky aktivitet do kryhet brenda muajit mars. Në këtë trajnim pjesëmarrësit do të njihen me të gjitha procedurat që duhen ndjekur lidhur me zhvillimin e këtij vlerësimi ndërkombëtar.	Titullari DV SPVKN SAP PA
10	Dhënia e një versioni provë të testit dhe të pyetësorit për çdo shkollë në mënyrë që të trajnohen nxënësit	Materiale që do u shpërndahen shkollave	Ky aktivitet do kryhet brenda muajit mars. Ky version provë testi dhe pyetësori do u jepet shkollave në mënyrë që të trajnohen nxënësit	DV SPVKN SAP PA

11	Sigurimi i logjistikës së nevojshme	Kryerja e të gjitha procedurave të prokurimit për sigurimin e logjistikës së nevojshme	<p>E gjithë logjistika e nevojshme duhet të jetë gati, në fillim të muajit mars.</p> <p>Të sigurohen kompjuterët/laptop të nevojshme për testimin;</p> <p>Të përgatitet harta dhe datat e testimit;</p> <p>Testimi i programit në çdo kompjuter që do të përdoret në testim;</p> <p>Tu jepet të gjithë ZVAP-eve dy versione të programit të testimit të nxënësve. I pari shërben për të trajnuar nxënësit rreth mënyrës së përdorimit të këtij programi për zhvillimin e testimit dhe i dyti për të testuar nëpër shkollat përkatëse kompjuterit që kanë gjendje.</p>	Titullari DV SPVKN SAP PA
----	-------------------------------------	--	---	---------------------------------------

12	Sensibilizimi lidhur me rëndësinë e testimit	Takime, shkresa, e-maile, fletushka	<p>Masat për realizimin e këtij aktiviteti:</p> <p>Përgatitja e fletushkave lidhur mbi testimin PISA dhe shpërndarja e tyre shkollave të përzgjedhura dhe ZVAP-ve. Të kërkohet nga shkollat që këto fletushka të vendosen edhe në këndin informativ të shkollës.</p> <p>Të kërkohet nga MAS që nga ana e tyre të mblidhen drejtuesit e ZVAP-eve dhe koordinatorëve rajonal, dhe të kërkohet nga ana e tyre një angazhim maksimal lidhur me rëndësinë kombëtare të testimit.</p> <p>Të kërkohet nga MAS që nga ana e tyre të kryhet një fushatë e gjerë sensibilizimi në media dhe me mjete të tjera mbi rëndësinë kombëtare të këtij testimi.</p> <p>Të gjenden mekanizma dhe mënyra për të motivuar nxënësit.</p> <p>Të shpërndahet një paketë me modele pyetjesh të PISA për shkollat e përzgjedhura dhe të përcillen në të gjitha shkollat pjesëmarrëse;</p> <p>Të përgatiten postera për shkolla dhe të përcillen në të gjitha shkollat pjesëmarrëse.</p>	Titullari DV SPVKN SAP PA
----	--	-------------------------------------	---	---------------------------------------



13	Përgatitja dhe dërgimi i materialeve të testimit në shkollat e përzgjedhura	Procesverbalet për dorëzimin e materialeve tek KR	<p>Ky proces duhet të përfundojë brenda muajit mars. Materialet e testimit përmbajnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Formularët e Marrjes së Materialeve.</li> <li>- Formulari i kampionimit të Nxënësve.</li> <li>- Formulari i Pjesëmarrjes në Sesion (mësues dhe nxënës).</li> <li>- Formulari i Logimit të Nxënësit.</li> <li>- Formulari i Logimit të Shkollës.</li> <li>- Formulari i Raportimit të Sesionit.</li> <li>- Fleta e punës për të Llogaritur Kuotat e Mungesave.</li> <li>- Formulari i Kthimit të Materialeve.</li> </ul> <p>a) Masat për realizimin e këtij aktiviteti:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Përgatitja e materialeve dhe printimi i tyre në dy kopje.</li> <li>✓ Dorëzimi me shkresë zyrtare Koordinatorit të DAR/ZA i materialeve të testimit.</li> </ul>	Titullari DV SPVKN SAP PA
----	---	---	---	---------------------------------------

14	Zhvillimi dhe monitorimi i testimit	Urdhra për kalendarin e testimit dhe monitorimin e testimit	Propozimi i kalendarit të testimit dhe miratimi i tij. Testimi parashikohet të zhvillohet në muajin prill. Urdhër për ngritjen e GP nga QSHA për monitorimin e procesit. Secili monitorues të dorëzojë raportin e monitorimit. Nëse do të jetë e nevojshme për qendrën e testimit që nuk do të ketë përfaqësues të QSHA të ngrihet një GP me bashkëpunëtorë të jashtëm për monitorimin e testimit. Secili monitorues të dorëzojë raportin e monitorimit.	Titullari DV SPVKN SAP PA
15	Mbledhja e materialeve të testimit	Procesverbale për mbledhjen e materialeve të testimit	Në procesverbale para marrjes në dorëzim të sigurohen që janë ruajtur përgjigjet e pyetjeve të instrumenteve të vlerësimit	Titullari DV SPVKN SAP PA

16	Kodimi i pyetjeve dhe profesioneve	Urdhër për koduesit e pyetjeve	<p>Ky proces fillon pas përfundimit të vlerësimit dhe përfundon brenda një muaji.</p> <p>Masat për realizimin e këtij aktiviteti:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Krijimi i databazës së nxënësve.</li> <li>- Marrja në dorëzim i HD dhe ngarkimi në sistem i të gjitha fileve të përgjigjeve të testit dhe pyetësorëve.</li> <li>- Krijimi në sistem i përdoruesve për kodim dhe i tre sesioneve të kodimit.</li> <li>- Shpërndarja e pyetjeve për kodim për secilin kodues.</li> <li>✓ Miratimi i skemës së vlerësimit dhe përcaktimi me urdhër i koduesve (për pyetjet dhe për profesionet).</li> <li>✓ Trajnimi i koduesve.</li> <li>- Përgatitja e materialeve trajnuesve.</li> <li>- Përgatitja dhe miratimi i afateve të kodimit.</li> <li>- Monitorimit i kodimit nga punonjës i QSHA, përgjegjës për kodimin.</li> <li>- Marrja e masave për ri kodim për pyetje që mund të rezultojnë problematike.</li> <li>- Përcaktimi i mjedisit ku do të kodohet dhe sigurimi i bazës logjistike të nevojshme.</li> </ul> <p>a) Risqet për realizimin e këtij aktiviteti:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Dëmtimi i fileve të përgjigjeve të nxënësve.</li> <li>❖ Konstatimi i rasteve me kodim jo të rregullt.</li> <li>❖ Mungesa e mjediseve dhe pajisjeve logjistike</li> </ul>	Titullari DV SPVKN SAP PA
----	------------------------------------	--------------------------------	---	---------------------------------------

17	Verifikimi dhe saktësimi i databazës për nxënësin, mësuesin dhe shkollën	Komunikime me e-mail me OECD	<p>Ky proces fillon në korrik dhe përfundon në muajin gusht.</p> <p>a) Masat për realizimin e këtij aktiviteti:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Miratimi nga OECD dhe marrja në dorëzim i programit të mbledhjes dhe dërgimit të të dhënave.</li> <li>✓ Transferimi i të dhënave në DME.</li> <li>✓ Konstatimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.</li> <li>✓ Dërgimi i databazës përfundimtare dhe marrja e miratimit nga OECD.</li> </ul> <p>b) Risqet për realizimin e këtij aktiviteti:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Mosfunksionimi korrekt i pajisjeve logjistike për transferimin e të dhënave online.</li> </ul> <p>Përballja me problematikat e mësipërme sjell dhe vonesën e miratimit të databazës nga OECD</p>	Titullari DV SPVKN SAP PA
VII	<b>VLERËSIMI NDËRKOMBËTAR TIMSS</b>			
1	Kampionimi i shkollave dhe nxënësve	Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet IEA, (International Association for the Evaluation of Educational Achievement)	Në këtë fazë kryhen në portalet e IEA të gjitha detyrat që lidhen me kampionimin dhe përzgjedhjen e shkollave dhe nxënësve	MAS Titullari DV SPVKN SAP PA

2	Zhvillim i vlerësimit dhe kodimi i pyetjeve	Manualet, udhëzimet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga IEA	Në këtë fazë kryhet zhvillimi i vlerësimit dhe më pas vijohet me kodimin e pyetjeve	Titullari DV SPVKN SAP PA
3	Dorëzimi i databazës finale	Manualet, udhëzimet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga IEA	Në këtë fazë kryhet validimi dhe dorëzimi i databazës finale	Titullari DV SPVKN SAP PA
<b>LISTA E AKTIVITETEVE NË REND KRONOLOGJIK, VLERËSIMI NDËRKOMBËTAR TIMSS</b>				
1	Mbledhja e të dhënave për klasat e katërta	Shkresa dhe e-maile me ZVAP-et	Ky aktivitet kryhet brenda muajit nëntor. Mbledhja e të dhënave për klasat e katërta, (numri i nxënësve dhe numri i klasave të katërta) për çdo shkollë nga ZVA përkatëse, kodimi dhe raportimi i tyre në IEA.	Titullari DV SPVKN SAP PA
2	Krijimi i bazës së të dhënave të të gjitha shkollave	E-maile me IEA	Ky aktivitet kryhet brenda muajit dhjetor. Krijimi i bazës së të dhënave të të gjitha shkollave, me adresat përkatëse dhe numrin e nxënësve në klasë të katërt dhe përcjellja e bazës së të dhënave te IEA Hamburg.	Titullari DV SPVKN SAP PA
3	Përzgjedhja e shkollave	E-mail nga IEA	Ky aktivitet kryhet brenda muajit dhjetor. IEA do të bëjë përzgjedhjen e shkollave që do të marrin pjesë në Vlerësim, i cili do të zhvillohet në muajin Mars.	Titullari DV SPVKN SAP PA

4	Ngarkimi i shkollave	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet kryhet brenda muajit dhjetor nga IEA. Ngarkimi i shkollave, pas kampionimit të tyre nga IEA Hamburg, në softin IEA Win3WS	DV SPVKN SAP PA
5	Përzgjedhja e klasave	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet kryhet brenda muajit dhjetor. Pasi IEA të ketë kryer përzgjedhjen e shkollave, nga QSHA do të bëhet përzgjedhja e klasave, në shkollat ku do të zhvillohet testimi (1 apo 2 klasa për secilën shkollë të përzgjedhur).	DV SPVKN SAP PA
6	Mbledhja e numrit të nxënësve dhe emrave të mësuesve	Komunikim me e-mail me ZVAP-et	Ky aktivitet kryhet brenda muajit dhjetor. Mbledhja e numrit të nxënësve për secilën nga klasat e katërta, si dhe emrave të mësuesve të Matematikës dhe Diturisë së Natyrës nga shkollat e përzgjedhura, nëpërmjet ZVA-ve.	DV SPVKN SAP PA
7	Ngarkimi i të dhënave në softin IEA Win3WS	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet kryhet brenda muajit dhjetor. Ngarkimi i të dhënave në softin IEA Win3WS dhe kryerja e kampionimit të klasave për këto shkolla (maksimumi 2 klasa për secilën shkollë).	DV SPVKN SAP PA
8	Mbledhja e të dhënave të nxënësve të përzgjedhur	Komunikim me e-mail me ZVAP-et	Ky aktivitet kryhet brenda muajit dhjetor. Mbledhja e të dhënave si emri dhe mbiemri i nxënësit, datëlindja dhe gjinia, të klasave të përzgjedhura, nëpërmjet ZVA-ve dhe ngarkimi i tyre në soft.	DV SPVKN SAP PA
9	Përkthimi dhe layout i materialeve të vlerësimit dhe të pyetësorëve të TIMSS 2022 FT	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet do të kryhet sipas afateve të vendosura nga IEA	DV SPVKN SAPA

<b>10</b>	Përkthimi i paketave të vlerësimit të arritjeve dhe pyetësorëve të nxënësit, të shtëpisë, të mësuesit dhe të shkollës.	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet do të kryhet sipas afateve të vendosura nga IEA, si afat përfundimtar deri në janar.	DV SPVKN SAP PA
<b>11</b>	Verifikimi i brendshëm i përkthimit të paketave të vlerësimit të arritjeve dhe pyetësorëve të nxënësit, të shtëpisë, të mësuesit dhe të shkollës.	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet do të kryhet sipas afateve të vendosura nga IEA, si afat përfundimtar deri në janar.	DV SPVKN SAP PA
<b>12</b>	Dërgimi i paketave të vlerësimit të arritjeve dhe pyetësorëve për fazën e verifikimit të përkthimit nga IEA Amsterdam.	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet do të kryhet sipas afateve të vendosura nga IEA, si afat përfundimtar deri në janar.	DV SPVKN SAP PA
<b>13</b>	Përkthimi i formularëve të frekuentimit të nxënësve, të frekuentimit të mësuesve, pjesëmarrjes dhe administrimit të testit.	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet do të kryhet sipas afateve të vendosura nga IEA, si afat përfundimtar deri në janar.	DV SPVKN SAP PA
<b>14</b>	Pasqyrimi dhe justifikimi i korigjimeve të paketave të vlerësimit të arritjeve dhe pyetësorëve pas verifikimit nga IEA Amsterdam dhe dërgimi për verifikim të layout në TIMSS Boston.	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet do të kryhet sipas afateve të vendosura nga IEA, si afat përfundimtar deri në janar.	DV SPVKN SAP PA

15	Pasqyrimi dhe justifikimi i korrigjimeve të paketave të vlerësimit të arritjeve dhe pyetësorëve pas verifikimit të layout nga TIMSS Boston.	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet do të kryhet sipas afateve të vendosura nga IEA, si afat përfundimtar deri në janar.	DV SPVKN SAP PA
16	Dërgimi i udhëzuesit të gjitha shkollave të përzgjedhura për përgatitjen e nxënësve për vlerësim	Shkresa, procesverbale	Ky aktivitet do të kryhet brenda muajit shkurt.	DV SPVKN SAP PA
17	Trajnimi i koordinatoreve dhe administratoreve	Trajnimi në QSHA, procesverbalet e trajnimit	Trajnim do kryhet në QSHA në muajin mars. Ky trajnim do kryhet sipas manualeve të IEA.	DV SPVKN SAP PA
18	Sigurimi i logjistikës së nevojshme	Kryerja e të gjitha procedurave të prokurimit për sigurimin e logjistikës së nevojshme	E gjithë logjistika e nevojshme duhet të jetë gati, në fillim të muajit mars. Të sigurohen kompjuterët/laptop të nevojshme për testimin; Të përgatitet harta dhe datat e testimit; Testimi i programit në çdo kompjuter që do të përdoret në testim; Tu jepet të gjithë ZVAP-eve dy versione të programit të testimit të nxënësve. I pari shërben për të trajnuar nxënësit rreth mënyrës së përdorimit të këtij programi për zhvillimin e testimit dhe i dyti për të testuar nëpër shkollat përkatëse kompjuterit që kanë gjendje.	Titullari DV SPVKN SAP PA



19	Sensibilizimi lidhur me rëndësinë e testimit	Takime, shkresa, e-maile, fletushka	<p>Masat për realizimin e këtij aktiviteti:</p> <p>Përgatitja e fletushkave lidhur mbi testimin dhe shpërndarja e tyre shkollave të përzgjedhura dhe ZVAP-ve. Të kërkohet nga shkollat që këto fletushka të vendosen edhe në këndin informativ të shkollës.</p> <p>Të kërkohet nga MAS që nga ana e tyre të mblidhen drejtuesit e ZVAP-eve dhe koordinatorëve rajonal, dhe të kërkohet nga ana e tyre një angazhim maksimal lidhur me rëndësinë kombëtare të testimit.</p> <p>Të kërkohet nga MAS që nga ana e tyre të kryhet një fushatë e gjerë sensibilizimi në media dhe me mjete të tjera mbi rëndësinë kombëtare të këtij testimi.</p> <p>Të gjenden mekanizma dhe mënyra për të motivuar nxënësit.</p> <p>Të shpërndahet një paketë me modele pyetjesh të PISA për shkollat e përzgjedhura dhe të përcillen në të gjitha shkollat pjesëmarrëse;</p> <p>Të përgatiten postera për shkolla dhe të përcillen në të gjitha shkollat pjesëmarrëse.</p>	Titullari DV SPVKN SAP PA
20	Dorëzimi i materialeve të testimit	Procesverbalet e dorëzimit	Dorëzimi i materialeve të testimit, kompjuter etj., tek koordinatori i shkollës (të paktën një javë para testimit)	DV SPVKN SAP PA
21	Zhvillimi dhe monitorimi i testimit	Urdhër për kalendarin dhe monitorimin e testimit	Testimi do të zhvillohet në muajin mars dhe do monitorohet.	DV SPVKN SAP GP PA

22	Kthimi i materialeve të testimit	Procesverbalet e dorëzimit	Të sigurohen që janë ruajtur përgjigjet e nxënësve dhe të instrumenteve të tjera dhe janë kthyer në rregull të plotësuar të gjitha materialet e testimit.	DV SPVKN SAP GP PA
23	Vlerësimi në sistem dhe hedhja e të dhënave	Urdhër për kodimin	Ky aktivitet të kryhet gjatë muajit prill	DV SPVKN SAP GP PA
24	Të dhënat i përcillen brenda 3 (tre) muajve pas testimit.	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet të kryhet në muajt maj, qershor dhe korrik	DV SPVKN SAP GP PA
25	Validimi i databazës	Komunikim me IEA	Validimi i databazës nga IEA, deri në fund të muajit korrik	DV SPVKN SAP GP PA
<b>VIII</b>	<b>VLERËSIMI NDËRKOMBËTAR PIRLS</b>			
1	Kampionimi i shkollave dhe nxënësve	Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet IEA, (International Association for the Evaluation of Educational Achievement)	Në këtë fazë kryhen në portalet e IEA të gjitha detyrat që lidhen me kampionimin dhe përzgjedhjen e shkollave dhe nxënësve	MAS Titullari DV SPVKN SAP PA

2	Zhvillim i vlerësimit dhe kodimi i pyetjeve	Manualet, udhëzimet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga IEA	Në këtë fazë kryhet zhvillimi i vlerësimit dhe më pas vijohet me kodimin e pyetjeve	Titullari DV SPVKN SAP PA
3	Dorëzimi i databazës finale	Manualet, udhëzimet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga IEA	Në këtë fazë kryhet validimi dhe dorëzimi i databazës finale	Titullari DV SPVKN SAP PA
<b>LISTA E AKTIVITETEVE NË REND KRONOLOGJIK, VLERËSIMI NDËRKOMBËTAR PIRLS</b>				
1	Mbledhja e të dhënave për klasat e katërta	Shkresa dhe e-maile me ZVAP-et	Ky aktivitet kryhet brenda muajit nëntor. Mbledhja e të dhënave për klasat e katërta, (numri i nxënësve dhe numri i klasave të katërta) për çdo shkollë nga ZVA përkatëse, kodimi dhe raportimi i tyre në IEA.	Titullari DV SPVKN SAP PA
2	Krijimi i bazës së të dhënave të të gjitha shkollave	E-maile me IEA	Ky aktivitet kryhet brenda muajit dhjetor. Krijimi i bazës së të dhënave të të gjitha shkollave, me adresat përkatëse dhe numrin e nxënësve në klasë të katërt dhe përcjellja e bazës së të dhënave te IEA Hamburg.	Titullari DV SPVKN SAP PA
3	Përzgjedhja e shkollave	E-mail nga IEA	Ky aktivitet kryhet brenda muajit dhjetor. IEA do të bëjë përzgjedhjen e shkollave që do të marrin pjesë në Vlerësim, i cili do të zhvillohet në muajin Mars.	Titullari DV SPVKN SAP PA

4	Ngarkimi i shkollave	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet kryhet brenda muajit dhjetor nga IEA. Ngarkimi i shkollave, pas kampionimit të tyre nga IEA Hamburg, në softin IEA Win3WS	DV SPVKN SAP PA
5	Përzgjedhja e klasave	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet kryhet brenda muajit dhjetor. Pasi IEA të ketë kryer përzgjedhjen e shkollave, nga QSHA do të bëhet përzgjedhja e klasave, në shkollat ku do të zhvillohet testimi (1 apo 2 klasa për secilën shkollë të përzgjedhur).	DV SPVKN SAP PA
6	Mbledhja e numrit të nxënësve dhe emrave të mësuesve	Komunikim me e-mail me ZVAP-et	Ky aktivitet kryhet brenda muajit dhjetor. Mbledhja e numrit të nxënësve për secilën nga klasat e katërta, si dhe emrave të mësuesve të Matematikës dhe Diturisë së Natyrës nga shkollat e përzgjedhura, nëpërmjet ZVA-ve.	DV SPVKN SAP PA
7	Ngarkimi i të dhënave në softin IEA Win3WS	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet kryhet brenda muajit dhjetor. Ngarkimi i të dhënave në softin IEA Win3WS dhe kryerja e kampionimit të klasave për këto shkolla (maksimumi 2 klasa për secilën shkollë).	DV SPVKN SAP PA
8	Mbledhja e të dhënave të nxënësve të përzgjedhur	Komunikim me e-mail me ZVAP-et	Ky aktivitet kryhet brenda muajit dhjetor. Mbledhja e të dhënave si emri dhe mbiemri i nxënësit, datëlindja dhe gjinia, të klasave të përzgjedhura, nëpërmjet ZVA-ve dhe ngarkimi i tyre në soft.	DV SPVKN SAP PA
9	Përkthimi dhe layout i materialeve të vlerësimit dhe të pyetësorëve	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet do të kryhet sipas afateve të vendosura nga IEA	DV SPVKN SAPA

<b>10</b>	Përkthimi i paketave të vlerësimit të arritjeve dhe pyetësorëve të nxënësit, të shtëpisë, të mësuesit dhe të shkollës.	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet do të kryhet sipas afateve të vendosura nga IEA, si afat përfundimtar deri në janar.	DV SPVKN SAP PA
<b>11</b>	Verifikimi i brendshëm i përkthimit të paketave të vlerësimit të arritjeve dhe pyetësorëve të nxënësit, të shtëpisë, të mësuesit dhe të shkollës.	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet do të kryhet sipas afateve të vendosura nga IEA, si afat përfundimtar deri në janar.	DV SPVKN SAP PA
<b>12</b>	Dërgimi i paketave të vlerësimit të arritjeve dhe pyetësorëve për fazën e verifikimit të përkthimit nga IEA Amsterdam.	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet do të kryhet sipas afateve të vendosura nga IEA, si afat përfundimtar deri në janar.	DV SPVKN SAP PA
<b>13</b>	Përkthimi i formularëve të frekuentimit të nxënësve, të frekuentimit të mësuesve, pjesëmarrjes dhe administrimit të testit.	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet do të kryhet sipas afateve të vendosura nga IEA, si afat përfundimtar deri në janar.	DV SPVKN SAP PA
<b>14</b>	Pasqyrimi dhe justifikimi i korigjimeve të paketave të vlerësimit të arritjeve dhe pyetësorëve pas verifikimit nga IEA Amsterdam dhe dërgimi për verifikim të layout në TIMSS Boston.	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet do të kryhet sipas afateve të vendosura nga IEA, si afat përfundimtar deri në janar.	DV SPVKN SAP PA

15	Pasqyrimi dhe justifikimi i korrigjimeve të paketave të vlerësimit të arritjeve dhe pyetësorëve pas verifikimit të layout nga TIMSS Boston.	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet do të kryhet sipas afateve të vendosura nga IEA, si afat përfundimtar deri në janar.	DV SPVKN SAP PA
16	Dërgimi i udhëzuesit të gjitha shkollave të përzgjedhura për përgatitjen e nxënësve për vlerësim	Shkresa, procesverbale	Ky aktivitet do të kryhet brenda muajit shkurt.	DV SPVKN SAP PA
17	Trajnimi i koordinatorëve dhe administratorëve	Trajnimi në QSHA, procesverbalet e trajnimit	Trajnim do kryhet në QSHA në muajin mars. Ky trajnim do kryhet sipas manualeve të IEA.	DV SPVKN SAP PA
18	Sigurimi i logjistikës së nevojshme	Kryerja e të gjitha procedurave të prokurimit për sigurimin e logjistikës së nevojshme	E gjithë logjistika e nevojshme duhet të jetë gati, në fillim të muajit mars. Të sigurohen kompjuterët/laptop të nevojshme për testimin; Të përgatitet harta dhe datat e testimit; Testimi i programit në cdo kompiuter që do të përdoret në testim.	Titullari DV SPVKN SAP PA
19	Sensibilizimi lidhur me rëndësinë e testimit	Takime, shkresa, e-maile, fletushka	Masat për realizimin e këtij aktiviteti: Përgatitja e fletushkave lidhur mbi testimin dhe shpërndarja e tyre shkollave të përzgjedhura dhe ZVAP-ve. Të kërkohet nga shkollat që këto fletushka të vendosen edhe në këndin informativ të shkollës.	Titullari DV SPVKN SAP PA

20	Dorëzimi i materialeve të testimit	Procesverbalet e dorëzimit	Dorëzimi i materialeve të testimit, kompjuter etj., tek koordinatori i shkollës (të paktën një javë para testimit)	DV SPVKN SAP PA
21	Zhvillimi dhe monitorimi i testimit	Urdhër për kalendarin dhe monitorimin e testimit	Testimi do të zhvillohet në muajin mars dhe do monitorohet.	DV SPVKN SAP GP PA
22	Kthimi i materialeve të testimit	Procesverbalet e dorëzimit	Të sigurohen që janë ruajtur përgjigjet e nxënësve dhe të instrumenteve të tjera dhe janë kthyer në rregull të plotësuar të gjitha materialet e testimit.	DV SPVKN SAP GP PA
23	Vlerësimi në sistem dhe hedhja e të dhënave	Urdhër për kodimin	Ky aktivitet të kryhet gjatë muajit prill	DV SPVKN SAP GP PA
24	Të dhënat i përcillen IEA brenda 3 (tre) muajve pas testimit.	Kryerja e proceseve në portalet e IEA	Ky aktivitet të kryhet në muajt maj, qershor dhe korrik	DV SPVKN SAP GP PA
25	Validimi i databazës	Komunikim me IEA	Validimi i databazës nga IEA, deri në fund të muajit korrik	DV SPVKN SAP GP PA

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi Përkatës</b>	<b>Shkurtime</b>
<b>1</b>	Drejtoria e Vlerësimit	DV
<b>2</b>	Sektori i Administrimit të Provimeve	SAP
<b>3</b>	Sektori i Provimeve dhe Vlerësimeve Kombëtare dhe Ndërkombëtare	SPVKN
<b>4</b>	Drejtoria e Shërbimeve Arsimore	DSHA
<b>6</b>	Drejtoria e Provimeve të Shtetit	DPSH
<b>6</b>	Personi i Autorizuar	PA
<b>7</b>	Grup Pune	GP

**PËRGJEGJËS I SEKTORIT TË ADMINISTRIMIT TË PROVIMEVE**

-----

**PËRGJEGJËS I SEKTORIT TË PROVIMEVE DHE VLERËSIMEVE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE**

-----

**DREJTOR I DREJTORISË SË VLERËSIMIT**

-----



## GJURMËT E AUDITIT PËR AKTIVITETET E DREJTORISË SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

<b>Lista e Proceseve të Punës Për Sektorin e Regjistrimit të Studentëve</b>				
<b>Hapat</b>	<b>Procesi</b>	<b>Akti ligjor, nënligjor apo akti i brendshëm</b>	<b>Aktivitetet e Kontrollit</b>	<b>Struktura/ Personi Përgjegjës</b>
<b>I</b>	<b>Pajisja e studentëve me numër matrikullimi</b>			

1	<p><b>Pajisja e studentëve me numër matrikullimi.</b></p> <p>Kontrolli i të dhënave të përcjella nga Universitetet Publike dhe Jopublike dhe përgatitja e bazës së të dhënave për dhënien e numrave të matrikullimit (NIM)</p> <p>Krijimi i bazës së të dhënave për të gjitha shkresat e përcjella nga IAL si dhe krijimi i bazës së të dhënave të studentëve.</p>	<p><i>Ligji i për arsimin e lartë, udhëzimet, vendimet dhe urdhrat e hapjeve të programeve të studimit nga MAS sa më poshtë:</i></p> <p><i>Ligji nr 80/2015.</i></p> <p>Udhëzimi nr.10/2019, i ndryshuar.</p> <p>Udhëzimi nr.6, datë 19.02.2018, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”, i ndryshuar</p> <p>Urdhrat e përbashkët të RASH dhe QSHA</p>	<p>Për të dhënë urdhrat e matrikullimit për secilin nga universitetet që sjell të dhëna pranë QSHA-së bëhet verifikimi i të dhënave për ciklin e parë, të dytë dhe cikli i tretë.</p> <p>Verifikimi i të dhënave konsiston:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përpunimi i të dhënave sipas template-it të Udhëzimit nr6/2018,i ndryshuar, të studentëve të regjistruar në ciklin e parë dhe të dytë.</li> <li>2. Kontrolli i studentëve të regjistruar: <ol style="list-style-type: none"> <li>a) Matching (përputhja)e listës së përcjellë nga IAL-ja me listën e studentëve që janë regjistruar në portalin U-Albania ,të përcjella nga RASH</li> <li>b) Verifikimi i studentëve të regjistruar me kuotat e miratuara dhe certifikuara nga MAS.</li> <li>c) Verifikimi dhe kontrolli në listat e studentëve të transferuar dhe të regjistruar si program II në të dyja ciklet e studimit.</li> <li>d) Verifikimi dhe diplomimi i secilit student ne sistemin e matrikullimit, të cilët rezultojnë të regjistruar në ciklin II, nga databaza e te diplomuarve si dhe diplomave(të cilët nuk gjenden te lista e te diplomuarve), lidhur me licencimin e programit të studimit.</li> <li>e) Njehsimi nga QSHA-ja i studentëve të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme /ciklin e parë jashtë vendit.</li> <li>f) Verifikohen të gjitha dokumentacionet e shkresat e ndryshme të përcjella nga IAL-të për regjistrimet në ciklet e ndryshme</li> </ol> </li> </ol>	Titullari DSHA SRS
---	--	--	---	--------------------------

Krijimi i të dhënave të studentëve të diplomuar ,të përcjella nga IAL-të Publike dhe Jopublike. Gjenerimi i numrave të matrikullimit për 39 IAL publike dhe jopublike.

Përgatitja e të dhënave për ngarkim në databazë dhe përcjellja e të dhënave me shkresë zyrtare çdo IAL-je.

3.Gjithashtu bëjmë te mundur ngarkimin ne sistem te programeve te reja te studimit, te hapura me Urdhër Hapje nga MAS.

Pas kontrollit përgatitet databaza për ngarkim pra të gjitha emërtimet e programeve të studimit vendosen në formatin e përshtatshëm gjithashtu verifikohen të gjitha dokumentacionet e shkresat e ndryshme të përcjella nga IAL-të për regjistrimet në ciklet e ndryshme.

Rregullohen të gjitha mangësitë në të dhëna nëse të dhënat nuk janë në formatin e duhur.

Bëhet ngarkimi i të dhënave i ndarë në skedarë. Për të dhënat që janë të pamundura të ngarkohet vendoset shkaku përkatës për secilin nga studentet rekordi i të cilit nuk ngarkohet.

Përgatiten shkresat përcjellëse përkatëse të cilat përmbajnë NIM për secilën IAL për të gjitha ciklet e studimit dhe problematikat e shfaqura për studentët e pa pajisur me NIM .

**PËRGJEGJËS I SEKTORIT TË REGJISTRIT TË STUDENTËVE**

-----

**DREJTOR I DREJTORISË SË SHËRBIMEVE ARSIMORE**

-----

**GJURMËT E AUDITIT PËR AKTIVITETET E SEKTORI I NJOHJES SË DIPLOMAVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE  
LEGALIZIMEVE**

**Lista e Proceseve të Punës Për Sektorin e Njohjes së Diplomave të Arsimit Parauniversitar dhe Legalizimeve**

<b>Hapat</b>	<b>Procesi</b>	<b>Akti ligjor, nënligjor apo akti i brendshëm</b>	<b>Aktivitetet e Kontrollit</b>	<b>Struktura/ Personi Përgjegjës</b>
<b>I</b>	<b>Legalizimi i dokumenteve të Arsimit Parauniversitar</b>			

1	<p>Legalizimi i dokumenteve të Arsimit Parauniversitar të kryer në Republikën e Shqipërisë</p>	<p>Ligji nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p> <p>VKM Nr.371, datë 26.04.2017, për krijimin e Oendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA)</p> <p>Marrëdhëniet e punës së punonjësve të QSHA-së rregullohen në bazë të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” Urdhër nr.16, datë 11.01.2018 i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, QSHA ngarkohet realizimin e procesit të legalizimit të dokumenteve të Arsimit Parauniversitar.</p>	<p>Hapi i parë në procesin e legalizimeve të dokumenteve të Arsimit Parauniversitar është depozitimi në QSHA i një kopjeje të urdhrimit të emërimit të drejtuesit të çdo Zyre Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), specimeni i firmës dhe vula e ZVAP-së përkatëse. Çdo ZVAP përgatit dokumentet që do të legalizohen. Më pas ZVAP-të i nisin ato me postë në QSHA, sipas pikës nr.4 të urdhrimit nr.16, datë 11.01.2018.</p> <p>Pasi mbërrijnë në QSHA, dokumentet protokollohen. Përgjegjësi i sektorit të Njohjes së Diplomave të Arsimit Parauniversitar dhe Legalizimeve (PLD) i merr nga zyra e protokollit, duke i çuar ato në sektorin përkatës., bashkë me librin e regjistrimeve të postës për legalizimet. Në sektor ndahen puna në mënyrë të tillë që procesi i legalizimi të dokumenteve të kryhet sa më shpejt, duke u shqyrtuar dhe , diskutuar rastet e veçanta. Në regjistrin e legalizimeve shkruhet emri i ZVAP-së nga vijënë dokumentet, numri i protokollit i vendosur nga ZVAP-ja prej nga vijënë, emri dhe mbiemri i personit në emër të të cilit është dokumenti dhe lloji i dokumentit. Në regjistrin fizik të legalizimeve çdo dokument merr një numër në regjistrin tonë. Ai nis me nr. 1 në fillim të çdo viti kalendarik. Në fund të vitit bëhet edhe regjistri elektronik.</p> <p>Më pas dokumentet e rregullta vulosen me vulën katrore, e cila më pas plotësohet me shkrim dore nga punonjësit e sektorit. Secili prej tyre ka të depozituar firmën e tij në zyrën përkatëse të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.</p> <p>Pasi kontrollohet puna e kryer, dokumentet futen nëpër zarfe sipas ZVAP-ve ku do të nisen. Sipas pikës nr.5 të Urdhër nr.16, datë 11.01.2018 i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, brenda 5 ditëve nga protokollimi në QSHA, dokumentet dërgohen në protokoll, prej nga nisen për në zyrat përkatëse me rrugë postare. Shpesh procesi mbyllet para afatit.</p> <p>Një pjesë e maturantëve plotësojnë një seksion të veçantë në aplikimet para provimeve të Maturës Shtetërore, për të studiuar jashtë vendit. Në periudhën kur ata sapo kanë marrë diplomat, MAS nxjerr një udhëzim në ndihmë të kësaj kategorie maturantësh, duke shmangur rrugën postare, me qëllim arritjen e afateve të aplikimit nëpër ambasadat e vendeve ku ata dëshirojnë të studiojnë. Në këto raste, dokumentet mund t’i sjellin nëfaqësues të ZVAP-ve të pajisur me autorizim nga titullari i tyre</p>	<p>Titullari DASH PLD</p> <p>PLD</p> <p>PLD dhe SLD</p> <p>PLD</p> <p>DSHA PLD</p>
---	--	---	---	--

II

**Procesi i njohjes së Diplomave të Arsimit Parauniversitar të kryera jashtë vendit**



	<p>Procesi i njohjes së Diplomave të Arsimit Parauniversitar të kryera jashtë vendit</p>	<p>Udhëzimi i MAS nr. 14 datë 10.05,2017, prot. nr. 4819, “Për një ndryshim në udhëzimin nr.44, datë 21.08.2013 “për përcaktimin e kritereve dhe procedurat e njëvlershmërisë të dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”</p> <p>Urdhra të QSHA-së për Sekretariatit Teknik dhe Komisionin e Posaçëm</p>	<p>Në faqen zyrtare të QSHA-së ndodhen udhëzimet se çfarë dokumentesh nevojiten, si duhet të përgatiten dhe si duhet të veprojnë çdo aplikant për njëvlershmërinë e diplomës/dëftesës së shkollës së mesme. Aplikimet vijnë në QSHA me rrugë postare. Protokollin e sjell në sektorin tonë pasi kryen procedurat e duhura. Këtu ndahen me specialistët praktikant sipas një ngarkese të caktuar, me afatet e duhura, duke mbajtur secili përgjegjësi për punën që i ngarkohet. Specialisti mban kontakte të vazhdueshme me përgjegjësin e sektorit dhe me drejtorin e drejtorisë. Puna përqendrohet te shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimeve të ardhura për njëvlershmërinë e diplomës së shkollës së mesme të përfunduar jashtë vendit.</p> <p>Për aplikimet që kanë mangësi, aplikantët njoftohen me email. Për dokumentet që kanë paqartësi ose pasiguri, bëhen kërkime në faqet zyrtare të vendeve përkatëse, komunikohet me institucione homologe ose rrjete që janë të njohur zyrtarisht për informacionin që zotërojnë për këto shkolla, si dhe për dokumentet që ato lëshojnë.</p> <p>Më pas procesi kalon në Komisionin e Posaçëm, për aplikimet pa mungesë dokumentacioni. Përgjithësisht procesi mbaron para afatit ligjor. Kur procesi i njëvlershmërisë ka mbaruar deri në përpilimin e dokumentit të praktikave të trajtuara, bëhet njoftimi me e-mail ose telefon i aplikantëve që kanë sjellë dokumentacion me mangësi dhe sqarimi i tyre. Në grup ose individualisht, me kërkesë të Komisionit të Posaçëm bëhen kërkime dhe studime të sistemeve arsimore parauniversitare të shteteve të huaja dhe përshtaten ato me sistemin arsimor parauniversitar shqiptar. Kur shihet se çdo gjë është konform rregullave, bëhet zbardhja e vendimit të Komisionit të Posaçëm sipas njëvlershmërisë së realizuar nga anëtarët e Komisionit dhe marrja e firmave të secilit anëtar. Më pas ato dërgohen në protokoll. Pasi firmosen nga titullari i institucionit, aplikantët njoftohen me email që dokumenti i tyre i njëvlershmërisë është gati. Aplikanti duhet të ketë dokumenton e identifikimit me vete kur të tërheqë dokumentin e njëvlershmërisë. Nëse do të vijë dikush tjetër, ai duhet të ketë prokurë të posaçme nga aplikanti. Nëse është familjar i tij, ai duhet të sjellë certifikatën familjare, ku vërtetohet lidhja e tyre. Cilido qoftë personi që vjen, ai firmos në regjistrin e dorëzimit të dokumentit të njëvlershmërisë. Të dhënat e aplikantëve hidhen në regjistrin elektronik.</p>	<p>DSHA PLD SLD</p>
--	--	---	--	-----------------------------

**PËRGJEGJËS I SEKTORIT TË NJOHJES SË DIPLOMAVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE LEGALIZIMEVE**

-----

**DREJTOR I DREJTORISË SË SHËRBIMEVE ARSIMORE**

-----

**GJURMËT E AUDITIT PËR AKTIVITETET E SEKTORIT TË REGJISTRIT TË NXËNËSVE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR**

**Lista e Proceseve të Punës Për Sektorin e Regjistrimit të Nxënësve të Arsimit Parauniversitar**

<b>Hapat</b>	<b>Procesi</b>	<b>Akti ligjor, nënligjor apo akti i brendshëm</b>	<b>Aktivitetet e Kontrollit</b>	<b>Struktura/ Personi Përgjegjës</b>
<b>I</b>	<b>Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar</b>			

1	Koordinimi me përfaqësuesit e DAR/ZA-ve dhe shkollave për të dhënat që janë duke u shtuar apo modifikuar në sistem.	Ligji 69/2012, i ndryshuar	Koordinimi i punës nga ana e Help - Desk për tu ardhur në ndihmë përdoruesve	Titullari DSHA SRN
1.1	Hedhja e të dhënave nga koordinatorët e shkollave dhe përfaqësues të tjerë në varësi të nevojave të softit		Vijimi i hedhjes së të dhënave për mësuesit dhe nxënësit e shkollave	
1.2	Krijimi i raporteve të ndryshme në varësi të kërkesave të MAS apo QSHA		Në aplikacion janë parashikuar një sërë raportesh dhe kërkesash. Në varësi të kërkesave shitesë do krijohen raporte të reja (për momentin një pjesë e tyre nga DB)	
1.3	Evidentimi i problematikave të ndryshme		Gjatë përdorimit të softit evidentohen problematika të ndryshme dhe do synohet gjetja e një zgjidhjeje për to.	
1.4	Komunikimi i vazhdueshëm me grupin e punës lidhur me përmirësimin e sistemit.		Përshtatja e sistemit bazuar në kërkesat e QSHA-së apo përdoruesve të tjerë	
	Komunikimi i vazhdueshëm me		Bazuar te TORs të firmosura të mund të realizohen përmirësimet e	

<b>2. Portali Maturanti</b>	Përmirësimi i softit Maturanti		Bazuar në ndryshimet në kurrikul dhe evidentimeve të bëra nga maturat e kaluara do të përshtatet sistemi në përputhje me këto ndryshime
	Ngarkimi i të dhënave të maturantëve A1/A1Z në portalin Maturanti		Pas plotësimi të formularëve A1/A1Z hidhen të dhënat e tyre te portali maturanti
	Konfigurimi i të dhënave fillestare i portalit Maturanti	<i>Rregullorja e MSH 2022, Udhëzime teknike përgatitur</i>	Konfigurimi i listës së shkollave, indeksit të profileve, lëndëve etj
	Mbartja e rezultateve të shkollës së mesme për aplikantët e viteve të kaluara	<i>udhëzimet përkatëse</i>	Për kandidatët që kanë qenë pjesë e MSH 2016-2021 dhe aplikojnë në MSH 2022 rezultatet mbarten dhe nuk është e nevojshme të ri hidhen nga mbikëqyrësit
	Përgatitja e formatit të certifikatave dhe suporti i vazhdueshëm gjatë fazës së hedhjes së rezultateve dhe printimit të certifikatave		Përgatitet baza e të dhënave për kandidatët e vitit akademik 2021-2022
	Përgatitja e bazës së të dhënave për vitin akademik 2021-2022 dhe		Në bazë të evidentimeve në vitin e kaluar dhe atyre që do vihen në dukje gjatë punës do punohet për lehtësimin e punës së personave përgjegjës për këtë detyrë

**PËRGJEGJËS I SEKTORIT TË REGJISTRIT TË NXËNËSVE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR**

-----

**DREJTOR I DREJTORISË SË SHËRBIMEVE ARSIMORE**

-----

**GJURMËT E AUDITIT PËR AKTIVITETET E SEKTORIT TË NJOHJES SË DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË, REGJISTRIMIT TË  
FORMAVE TË DIPLOMAVE DHE PAJISJES SË IAL-VE ME REGJISTRA**



**Lista e Proceseve të Punës për Sektorin e Njohjes së Diplomave të Arsimit të Lartë, regjistrimit të formave të diplomave dhe pajisjes së IAL-ve me regjistra.**

<b>Hapat</b>	<b>Procesi</b>	<b>Akti ligjor, nënligjor apo akti i brendshëm</b>	<b>Aktivitetet e Kontrollit</b>	<b>Struktura / Personi Përgjegjës</b>
<b>I</b>	Regjistrimi i formave të diplomave që lëshohen nga IAL-të.			

1	Paraqitja e aplikimit nga IAL-të.	Neni 91 të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimi nr. 10, datë 30.03.2020 i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës, ose certifikatës të lëshuar nga Institucionet e Arsimit të Lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, i ndryshuar.	Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL-të) paraqesin nëpërmjet postës kërkesën për regjistrimin e formave të diplomave që ato lëshojnë, duke i bashkangjitur dokumentacionin sipas përcaktimeve në udhëzim.	Drejtori i DSHA Sektori përkatës.
2	Shqyrtimi i dokumentacionit nga grupi i punës.	Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA për ngritjen e grupit të punës për regjistrimin e formave të diplomave.	Sektori i Njohjes së Diplomave të Arsimit të Lartë, regjistrimit të formave të diplomave dhe pajisjes së IAL-ve me regjistra nëpërmjet grupit të punës të ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA shqyrton dokumentacionin përkatës dhe nëse ai është i plotë konform kuadrit ligjor në fuqi, përgatit raportin përkatës që i drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm (D.P), së bashku me urdhrat dhe vërtetimet përkatëse me numrin unik të identifikimit.	Drejtori i DSHA Sektori përkatës.

3	Regjistrimi i formave të diplomave.	Neni 91 të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimi nr. 10, datë 30.03.2020 i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës, ose certifikatës të lëshuar nga Institucionet e Arsimit të Lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, i ndryshuar.	Në përfundim të procesit, D.P firmos urdhrat dhe vërtetimet përkatëse në tre kopje, një kopje e të cilave i dërgohet nëpërmjet postës IAL-ve. Një kopje së bashku me dokumentacionin përkatës ruhet në protokoll dhe një kopje mbahet nga sektori përkatës.	Drejtori i DSHA Sektori përkatës.
4	Mbajtja e regjistrave në formatin hard copy dhe elektronik. Përditësimi i faqes zyrtare të QSHA.	Udhëzimi nr. 10, datë 30.03.2020 i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës, ose certifikatës të lëshuar nga Institucionet e Arsimit të Lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, i ndryshuar.	Personi përgjegjës në sektor mban regjistrin përkatës në formatin hard copy dhe në formën elektronike, cila publikohet në faqen zyrtare të QSHA: qsha.gov.al	Drejtori i DSHA Sektori përkatës.



